



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.975/4 prot

Datë 01.06.2023

V E N D I M
Nr. 452/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.06.2023 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NG Structures” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-60492-02-27-2023, me objekt: “*Rikonstruksioni i Poliklinikës së Spitalit Rajonal Durrës*”, me fond limit 97.099.488 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës
Rruga “Aleksandër Goga”, Lagja Nr. 8, Durrës

Ankimues: Operatori ekonomik “NG Structures” SHPK
Lagja “Selam Musai”, Rruga “Dule Dalani”, Nr. Pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dytë, Tepelenë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-60492-02-27-2023, me objekt: “Rikonstruksioni i Poliklinikes së Spitalit Rajonal Durrës”, me fond limit 97.099.488 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 19.04.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------|----------------------------------|
| 1. “NG STRUCTURES” SHPK | 62.602.879,71 lekë, skualifikuar |
| 2. “ED KONSTRUKSION” SHPK | 67.973.478,08 lekë, kualifikuar |
| 3. “2 N” SHPK | 68.853.869 lekë, kualifikuar |

4. “Shendelli” SHPK	70.719.167,70 lekë, kualifikuar
5. “EURONDERTIMI 2000 ” SHPK	71.873.927 lekë, kualifikuar
6. “T & XH” SHPK	73.895.067,78 lekë, kualifikuar
7. “KEVIN KONSTRUKSION” SHPK	74.277.842,28 lekë, kualifikuar
8. “NIKA” SHPK	74.674.501,51 lekë, kualifikuar
9. “LIS KONSTRUKSION” SHPK	75.634.717 lekë, kualifikuar
10. “C O L O M B O” SHPK	75.744.766 lekë, skualifikuar
11. “INA” SHPK	78.134.088,77 lekë, kualifikuar
12. “DESARET COMPANY” SHPK	82.965.072,56 lekë, kualifikuar
13. “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK	83.773.604,40 lekë, kualifikuar
14. “Ante-Group” SHPK	84.421.781,20 lekë, kualifikuar
15. “ASI-2A CO” SHPK	84.843.453,68 lekë, kualifikuar
16. BOE “BE - IS” SHPK & “HTM” SHPK	86.068.302,42 lekë, kualifikuar
17. “CURRI” SHPK	89.308.434,51 lekë, skualifikuar
18. “PEPA GROUP GROUP” SHPK	89.331.744,03 lekë, kualifikuar
19. “MODESTE” SHPK	94.067.451,05 lekë, kualifikuar
20. “ELDA-VL” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
21. “Furst Koloss” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
22. “Eduart Çela” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.3. Në datën 03.05.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.4. Operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

- *Nuk përmbush kriteret sipas Shtojcës 2 “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.” Konkretisht zëri A-6 Punime tavani, suvatimi dhe veshje,5. Punime 2,181 Konstruksiione metalike të përbëra është ofertuar pa cmim.*

II.5. Në datën 08.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3078, si dhe nr. protokollit 975/2023 datë 08.05.2023 e operatorit ekonomik “NG Structures” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.975/2 prot., datë 09.05.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “NG Structures” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 723/3 prot., datë 22.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 975/3 prot., datë 29.05.2023 me objekt “Kthim përgjigje mbi ankesën me nr.975 prot., datë

08.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 723 prot., dt.09.05.2023” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “NG Structures” SHPK dhe me shkresën nr. 723/3 prot., datë 22.05.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se zëri me numër analize 2.181 është një zë i preventivit të cilit i është vënë çmimi për njësi dhe si i tillë ky zë preventivi nuk përbën një zë të pa ofertuar. Por ai është një zë punimi të cilit i është vënë çmimi për njësi konkretisht 220.000 Lek/ton dhe si rrjedhim KVO-ja duhet të kishte realizuar të gjitha veprimet administrative, sipas parashikimeve të LPP dhe pikës 3 të nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” për korrigjimin e ofertës. Gjithashtu KSHA, është i mendimit se AK nuk mund të blej të njëjtin zë punimesh, me të njëjtin numër analize me specifikime teknike të përcaktuara, me çmime të ndryshme. Kjo sepse do të binte ndesh me parashikimet e germës a) të pikës 1 të nenit 39 Kërkesat e Veçanta për kontratat për punët publike, ku është përcaktuar se:

1.Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuar në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Për sa më sipër, ankesa e OE “NG Structures” qëndron.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “NG Structures” SHPK dhe me shkresën nr. 723/3 prot., datë 22.05.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

“[...]

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se zëri me numër analize 2.181 është një zë i preventivit të cilit i është vënë çmimi për njësi dhe si i tillë ky zë preventivi nuk përbën një zë të pa ofertuar. Por ai është një zë punimi të cilit i është vënë çmimi për njësi konkretisht 220.000 Lek/ton dhe si rrjedhim KVO-ja duhet të kishte realizuar të gjitha veprimet administrative, sipas parashikimeve të LPP dhe pikës 3 të nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” për korrigjimin e ofertës. Gjithashtu KSHA, është i mendimit

se AK nuk mund të blej të njëjtin zë punimesh, me të njëjtin numër analize me specifikime teknike të përcaktuara, me çmime të ndryshme. Kjo sepse do të binte ndesh me parashikimet e germës a) të pikës 1 të nenit 39 Kërkesat e Veçanta për kontratat për punët publike, ku është përcaktuar se:

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Për sa më sipër, ankesa e OE “NG Structures” qëndron.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në

përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në autoritetin kontraktor (referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar në KPP) dhe as në Komisionin e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konkretisht aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “NG Structures” SHPK, kështu që rrjedhimisht, për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuar, Komisioni në mbështetje të nenit 115 pika 3 gërma a), mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NG Structures” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NG Structures” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-60492-02-27-2023, me objekt: “Rikonstrukcioni i Poliklinikes së Spitalit Rajonal Durrës”, me fond limit 97.099.488 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NG Structures” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

